**”GURI COMPANY” SH.P.K. RAÇAK, SHTIME**

# RAPORT
# I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**Për bluarjen, seperimin e gurit të mermerizuar dhe prodhimin e gurëve dekorativ në Raçak, Shtime**

**Qershor, 2025**

**”GURI COMPANY” SH.P.K. RAÇAK, SHTIME**

# RAPORT
# I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**Për bluarjen, seperimin e gurit të mermerizuar dhe prodhimin e gurëve dekorativ në Raçak, Shtime**

**Hartues i VNM-së:**
**Dr.sc. Raif Bytyçi, inxh. i mjedisit, person fizik i licencuar**

**Aplikon për Pëlqim Mjedisor:**
**”Guri Company” sh.p.k.**

**Qershor, 2025**

## PËMBAJTJA


1. HYRJE........................................................ 5

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT........................................................ 6

2.1 Rregullativa ligjore........................................................ 6

2.2. Metodologjia e punës........................................................ 8

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT........................................................ 9

3.1. Pozita gjeografike e lokacionit........................................................ 9

3.2. Pozita gjeografike e zonës se shfrytëzimit........................................................ 10

3.3. Popullsia dhe vendbanimet ........................................................ 11

3.4. Lidhjet e kumunikacionit ........................................................ 11

3.5. Kushtet klimatike........................................................ 11

3.6. Relievi........................................................ 12

3.7. Hidrogjeologjia........................................................ 12

3.8. Gjeologjia ........................................................ 12

3.9. Ndërtimi gjeologjik i vendburimit dhe rrethinës se gjere........................................................ 12

3.10. Bota shtazore – fauna........................................................ 13

3.11. Peiszazhi ........................................................ 14

3.12. Dukshmëria ........................................................ 14

3.14. Ajri ........................................................ 14

3.15. Uji ........................................................ 14

4. PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK ........................................................ 15

4.1. Projekti teknologjik për bluarjen, seperimin dhe përpunim ........................................................ 16

4.2. Alternativat e projektit ........................................................ 21

5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS ........................................................ 24

5.1. Ndikimet ne ajër ........................................................ 24

5.2. Ndikimet ne tokë ........................................................ 24

5.3. Ndikimet ne ujëra ........................................................ 24

5.4. Ndikimi në peisazh........................................................ 25

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë ........................................................ 25

5.6. Ndikimi në popullate ........................................................ 25

5.7. Zhurma ........................................................ 26

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore ........ 26
6. MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT ........ 27
6.1. Masat për mbrojtjen e ajër ........ 27
6.2. Masat për mbrojtjen e tokës ........ 27
6.3. Masat për mbrojtjen e ujërave ........ 28
6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma ........ 28
6.5. Masat për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore ........ 29
6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale ........ 29
6.7. Aktivitetet në raport me publikun ........ 29
7. MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETEVE ........ 30
8. MONITRORIMI ........ 33
9. RAPORTIMI ........ 33
10. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE ........ 34
11. PËRFUNDIMI ........ 35

# 1. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar në lokacionin e Reçakut, Komuna Shtime.

Ngastra e lartë cekur që investitori kërkon pëlqimin mjedisor janë pasuri shoqërore e kombinatit te drurit - sktori i pyjeve. Kompania ”Guri Company” sh.p.k. për këto ngastra është pajisur me Pëlqimin e Komunës (bashkëngjitur në shtojcë të VNM-së).

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar si dhe prodhimin e gurëve dekorativ, është punuar në bazë të kërkesës së kompanisë ”Guri Company” sh.p.k. për të aplikuar për Pëlqim Mjedisor, i cili është një dokument i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për marrjen e lejes për Vendosja e mekanizmit për bluarje dhe seperim si dhe kryerjen e aktiviteteve tjera minerare, në lokalitetin e Ra çmimi akut, komuna e Shtimes.

Në raport do të analizohen ndikimet në mjedis të tërë proceseve teknologjike bluarjen,seperimin dhe përpunimin e gurit të Mermerizuar si dhe prodhimin e gurëve dekorativ, duke i parashtruar dhe ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do te ushtrohet kjo veprimtari dhe rreth tije.

Duke analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhiniere - teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, behet hartimi i VNM -se, ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin bluarjen dhe seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar si dhe prodhimin e gurëve dekorativ me mjedisin.

Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Me rastin e hartimit të raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së përgatitjes së lokacionit, gjatë fazës së realizimit të procesit teknologjik për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar, dhe pas përfundimit të projektit.

## 2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT TE VNM-së

Raporti i VNM-së është hartuar ne baze të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/l-181 (2023), i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së. Ky Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis ka për qellim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore te projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qellim që të parandalojnë dhe tëzvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis ne kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit të bazës për prodhimin e batonit dhe atë:

Identifikimin e burimit të ndotjes që rrezikon mjedisin

vlerësimin e ndikimit në mjedis

propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimevenegative gjer në kufijtë e lejuar.

### 2.1. Rregullativa ligjore për hartimin e VNM-së

**a). Dokumentacioni normativ**

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM -së për ”Guri Company” sh.p.k. janë marrë për

bazë ligjet me te rëndësishme ne vend, si:

**b). Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025**

- Ligji nr. 08/l-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji për mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 (2012) për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197

- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë
- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhevlerat kufizuese te shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhenë trupin ujor
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ MMPH, Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale.
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës
- Udhëzimi administrativ Nr.05/13. për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturine.

**a) Dokumentacioni teknik**

Gjendja reale aktuale e ”Guri Company” sh.p.k. për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar në lokacionin e Reçakut, Komuna Shtime – dokumentacioni përkatës:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit
- Pëlqimin e komunës ose njoftim - informatë sipas PZHK.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirënë kuadër të rregullat ivës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullat iva relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së (85/337/EEC).

## 2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për ”Guri Company” sh.p.k. për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar në lokacionin e Reçakut - Shtime, me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza.

**a). Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:**

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

**b). Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve**

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

**c). Analiza e rrezikimit të**

- njeriut
- vlerave materiale
- vlerave natyrore.

**d). Përcaktimi i masave mbrojtëse**

Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit nëmjedis në lokacionin e ”Guri Company” sh.p.k. për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar në Reçak - Shtime.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjenaktuale të mjedisit në këtë lokacion.

# 3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM -së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike,gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologji.

## 3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni "Guri Company" sh.p.k. për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar gjendet në njësitë kadastarle Reçak, Zona Kadastrale Shtim, në parcelat:

*P - 728 09071- 000 - 0*

*P - 728 09071- 009 - 0*

*P - 728 09071- 008 - 0*

*P - 728 09071- 074 - 0*

VNM – Për pjesa e ngastrave ne njësitë kadastarle Reçak, Zona Kadasreale Shtim do të përmbajë edhe situacionin e punuar nga gjeodeti i licencuar bashkangjitur (VNM-se) dhe do ti ketë këto koordinata:

| ***Koordinatat*** | | |
|---|---|---|
| Nr. | Y | X |
| 1 | 7520180.845 | 4675383.195 |
| 2 | 7520256.620 | 4675404.824 |
| 3 | 7520253.994 | 4675438.058 |
| 4 | 7520241.329 | 4675466.003 |
| 5 | 7520198.131 | 4675460.396 |

## 3.2. Pozita gjeografike e zonës se shfrytëzimit

Ne lokacionin ku investitori planifikon të e bëj bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar si dhe prodhimin e gurëve dekorativ, ne kohën e kryerjes se raportit të VNM, e ka të rregulluar infrastrukturën rrugore dhe rrafshimin e terrenit për fillimin e punimeve për vendosjen e mekanizmit për prodhimin e gurëve dekorativ, shoqëruar me aktivitetet tjera minerare. U cek më lart se lokacioni gjendet në pjesën jugore të Kosovës respektivisht Z.K. Raçak, Shtime. Është një lokacion i përshtatshëm për zhvillimin e kësaj veprimtarie duke mos pasur ndikime negative për mjedisin.

Ngastrat në Z.K Raçak në të cilat planifikohet të bëhet vendosja e mekanizmit për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar, gjendet e përcaktuar brenda kufijve të përcaktuar në kopjen e planit, që do të i bashkëngjitet raportit të VNM-se dhe do të shënohen ne vijim. Ne këtë lokacion ne afërsi të drejt për drejt nuk ekzistojnë objekte të banimit.

Ne bazë të rezervave të gurit te mermerizuar me të cilat disponon kompania edhe në lokacione tjera, kjo linjë duhet të punojë për një kohë të gjatë dhe bazuar ne pozitën gjeografike të lokacionit që gjendet larg vendbanimeve, ne këtë lokalitet ekzistojnë edhe kompani tjera që bëjnë bluarjen dhe seperimin. Sipërfaqja e tokës (ngastrave ku investitori do të bëj seperimin e gurit dhe për rreth tyre është e mbuluar me një shtresë të pa përfillshme të humusit dhe me vegjetacion të ndryshëm: bari të egër të mbirë vetë, shkurre dhe ne vende të shumta shihet guri i mermerizuar ne sipërfaqe, i zbuluar, figura ne vijim.



*Figura 1. Pamjet e lokacionit te projektit*

## 3.2. Popullata dhe vendbanimet

Shtimja shtrihet në skajin perëndimore të Rafshit të Kosovës. Kjo dhe rrethina e saj zënë vend në pjesën jugore të Kosovës. Koordinatat gjeografike te kësaj komunë janë : 42° 26' V dhe 21° 02' L. Komuna e Shtimes përbenë 1,2 për qind të territorit të Kosovës. Rrethe 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore.

Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë qytetin e Shtimes, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore - malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore. Shumica e fshatrave të komunës janë të lidhura me qytetin me rrugë të paasfaltuara dhe momentalisht vetëm dy rrugë janë të asfaltuar

Shtimje është trekëndësh gjeografik që lidhë Prishtinën me Prizrenin, po ashtu Shkupin gjegjësisht Ferizajin me Prizrenin dhe anasjelltas. Komuna e Shtimes ka 24 fshatra. Shtimja i kishte dhe i ka këto të mira natyrore: lumin në mes, malet dhe tokën pjellore. Prej kohësh kishte edhe rrugën që lidhte Perëndimin me Lindjen dhe anasjelltas. Të gjitha këto bënë që ky vendbanim të ekzistojë që nga kohët më të vjetra.

## 3.3. Lidhjet e komunikacionit

Lidhjet e komunikacionit me këtë lokacion janë të mira sepse mundë të shfrytëzohet rruga magjistrale Kaçanik -Hani Elezit po ashtu edhe autostrada “Arbër Xhaferi” për nevojat e kompanisë. Duke shfrytëzuar këto dy artere rrugore, qasja është e mundur me të gjitha viset e Kosovës.

## 3.4. Kushtet klimatike

Në këtë zonë mbizotëron një klimë e butë kontinentale, karakteristikë e kësaj klime është sepse dimrat janë të ashpër e me lagështi kurse vera e nxehtë dhe e thatë.

Varirimi i temperaturave në këtë zonë është ditorë, mujorë dhe vjetorë, kurse lëkundjet e vogla të temperaturave vjetore janë karakteristikë e këtij baseni. Temperaturat më të ulëta janë në muajt Dhjetor, Janar dhe shkurt, ndërsa ato më të larta janë në muajt Korrik dhe Gusht. Në zonën e vendburimit mbizotëron një klimë e butë kontinentale kurse në pjesën jugperëndimore është klimë malore e cila shpesh është e ndërthurur me mikroklimat e kushtëzuara nga alterimi i luginave lumore në malet e larta që është karakteristikë e këtij rajoni e këto se bashku ndikojnë në modifikime të ndryshme të klimës kontinentale.

Në klimën e kësaj zone rol të rëndësishëm luan edhe rrjeti hidrografik i cili imponon edhe një mikroklimë në vete lokale e cila bënë që dimri të jetë më i butë dhe vera më e frerskët. Temperaturat

mesatare gjat dimrit luhaten nga -0.5 deri +0.5°C por në raste të rralla temperaturat kanë kaluar edhe -22 °C , ndërsa gjatë verës variojnë nga 21.5 deri 22.8 °C.

## 3.5. Relievi

Zona e kërkuar e vendburimit nga pikëpamja fiziko-gjeografike gjendet dhe i përket zonës së Shtimës e cila dallohet për një reliev kodrinoro - malor , shtrihet në pjesën jug - lindore të rrugës egnatia.

## 3.6. Hidrogjeologjia

Kjo zonë në kuptimin hidrogjeologjik i takon ujëmbledhësit Lumit i cili e ndan qytetin ne dysh quhet Shtimjanka i cili me prurjet e tije me kohë ka bërë pasurimin e kësaj zone dhe ti bëjë tokat e punuara shumë pjellore. Pjesa veriore në raport me VB është e përbërë nga argjilat mellonite dhe mergelët.

## 3.7. Pedologjia

Tipet më të përfaqësuara të tokave në territorin e Komunës së Shtimësjanë toka ranore (lugina e Lepencit), me më tepër se 20% kurse pjesa tjetër është teren kodrinoro malorë me mjaft mineralizime me interes në sektorin minerar por të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimtarinë bujqësore të cilat do të kishin leverdi ekonomike, ato toka janë nën pyje ose të zhveshura të cilat mund të shfrytëzohen për aktivitete industriale duke respektuar kushtet mjedisore.

## 3.8. Ndërtimi gjeologjik i vendburimit dhe rrethinës se gjere

Zona ku do të bluhen, seperohen dhe përpunohen gurët e mermerizuar - zona ku do të kryhen hulumtime për gurë të mermerizuar në afërsi të Shtimes mes fshatrave Belinc, Raçak dhe Rancë, është zonë e mbivendosur transgresivisht në Miocen. Kjo zonë ka filluar jetën e sajë të historisë gjeologjike në kohën tektogjenezës alpine, me zhvillim të vrullshëm në Mesozoik. Në kenozoik një pjesë e sajë pësoi veprimtari të dendur të tektonikës disjunktive (horst grabenore).

Kjo veprimtari tektonike bëri që teritori i kosovës, i cili bënte pjesë në pellgun e madh Mesdhetar, në fundë të kenozoikut të kthehet në kushtet e një pellgu det-liqen paratetisian, duke u ndarë her në pellgje të veçanta her të bashkuara brenda malor me një zhvillim më të qetë gjeologjik me subsidencë apo ulje të madhe që sollën një depozitim shum të madh të depozitimeve liqenore.

Në afërsi të Shtimes mes fshatrave Belinc, Raçak dhe Rancë, është zonë e mbivendosur transgresivisht në Miocen. Kjo zonë ka filluar jetën e sajë të historisë gjeologjike në kohën tektogjenezës alpine, me zhvillim të vrullshëm në Mesozoik. Në kenozoik një pjesë e sajë pësoi veprimtari të dendur të tektonikës disjunktive (horst grabenore).
Kjo veprimtari tektonike bëri që territori i Kosovës, i cili bënte pjesë në pellgun e madh Mesdhetar, në funde të kenozoikut të kthehet në kushtet e një pellgu det-liqen paratetisian, duke u ndarë her në pellgje të veçanta her të bashkuara brenda malor me një zhvillim më të qetë gjeologjik me subsidencë apo ulje të madhe që sollën një depozitim shum të madh të depozitimeve liqenore.

## 3.9. Bimësia dhe vegjetacioni

Zona ku do bluhet seperohet dhe përpunohen gurët e mermerizuar, gjendet në afërsi të Shtimes mes fshatrave Belinc, Raçak dhe Rancë, është zonë e mbivendosur transgresivisht në Miocen.
Kjo zonë ka filluar jetën e sajë të historisë gjeologjike në kohën tektogjenezës alpine, me zhvillim të vrullshëm në Mesozoik. Në kenozoik një pjesë e sajë pësoi veprimtari të dendur të tektonikës disjunktive (horst grabenore).
Në funde të kenozoikut të kthehet në kushtet e një pellgu liqen paratetisian, duke u ndarë her në pellgje të veçanta here të bashkuara brenda malor me një zhvillim më të qetë gjeologjik me subsidencë apo ulje të madhe që sollën një depozitim shume të madh të depozitimeve liqenore. Kufijt administrativ të vendburimit të gurëve dekorativ i përkasin terrritorit të komunës së Shtimës, kurse vendburimi ndodhet i kufizuar me këto kordinata.

## 3.10. Bota shtazore – fauna

Zona e ngushtë mund të quhet si zonë e përshtatshme për zhvillimin e specieve të ndryshme të faunës sepse është zona jo në aferës të vendbanimeve.
Bazuar ne florën ekzistuese dhe kushtet klimatike dhe të dhënave nga vendasit në këtë zonë përveç kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë edhe gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri, dhelpra, iriqi etj.
Prej brejtësve jetojnë- mijtë, prej zvarranikëve - gjarpri i zakonshëm, bolla, breshkat e tokës hardhuca e gjelbër, insektet krahë fortë , krahë lusporë, mizat etj, prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat , bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja, lakuriqi, etj.

## 3.11. Peizazhi

Peizazhi është i tipit të kombinuar më kodrina të ulëta dhe të larta të cilat shtrihen në të dy anët e ngastrave. Gjerësia e kësaj kodrine është e ndryshme me një pamje mjaft të bukur dhe tërheqëse. Peizazhi është i dëmtuar (ndryshuar) nga ai fillestar për shkak të përgatitjes së platosë për vendosjen e makinerisë  në disa pjesë të këtij regjioni po edhe në vetë lokacionin. Në përgjithësi peizazhi është i bukur, tërheqës dhe me ajër të pastër.

## 3.12. Dukshmëria

Shikuar nga pozita e lokacionit ku do të përpunohet guri i mermerizuar, dukshmëria është mjaft e lartë në të gjitha anët e horizontit. Ne pjesën jug-perëndimore dhe ajo jug-lindore ka një dukshmëri ma te madhe. Vendet që shtrihen ne këtë lokalitet karakterizohen më mjegulla dhe më lagështi të madhe të ajrit gjatë stinës së dimrit përgjatë luginës së Lumit Shtimjanka.
Edhe kjo zonë nuk përjashton nga ky fenomen por në masë më të vogël, sepse nuk ka kurrfarë uzine e as diçka tjetër që e rritë ndotjen e ajrit dhe për rrjedhojë e zvogëlon dukshmërinë.

## 3.13. Ajri

Vegjetacioni i mirë, prania e madhe e llojeve të ndryshme të faunës janë treguesit kryesor për pastërtinë e ajrit. Kjo është zonë kryesisht bujqësore (blegtori), në afërsi nuk ka ndonjë uzinë ose aktivitet tjetër prodhues që do të ndikonte në ndotjen e ajrit. Mund të kolaudojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të mire.

## 3.14. Uji

Shikuar në aspektin Gjeomorfologjik, rajoni i gjerë i lokacionit ku do të vendoset linja e përpunimit të gurit të mermerizuar, mund të ndahet në pjesën e rrafshit që nënkupton luginën e lumit Shtimjanka me kuotat prej 630 në rrethinën e Reçakut deri 750 m në zonën e gurëve të mermerizuar. Kjo zonë në kuptimin hidrogjeologjik i takon ujëmbledhësit të lumit i cili e ndan qytetin ne dysh quhet Shtimjanka i cili me prurjet e tijë me kohë ka bërë pasurimin e kësaj zone dhe ti bëjë tokat e punuara shumë pjellore. Pjesa veriore në raport me VB është e përbërë nga argjilat mellonite dhe mergelet.

# 4. PËRSHKRIMI I PROCESIT TË BLUARJES, SEPERIMIT, PËRPUNIMIT TE GURIT TË MERMERIZUAR DHE PRODHIMIN E GURËVE DEKORATIV

Duke u bazuar në veprimtarin zhvilluese të kompanisë dhe nevojave të zhvillimit të biznesit për shkak të kërkesave të tregut kompania “Guri Company” sh.p.k.” ka pru vendim për vendosjen e një linje për përpunimin e gurëve të mermerizuar si nevojë e madhe për tregun e Kosovës.

Ky lloj i gurit mundë të përdoret për përdorim të mbrendshëm dhe për ambiente të jashtme, parqe dhe dekorime të ndryshme.

Gurët e përpunuar do të jenë të gabariteve kryesisht 30, 60 dhe 90 mm dhe do të përpunohen sipas kërkesave të klientëve në treg.

Guri për ambiente të brendshme do të jetë i disponueshëm në disa lloje dhe metoda të përpunimit. Për brendësinë e banesës apo shtëpisë, guri është natyral dhe nuk ka dy pjesë identike, që do të thotë se çdo pjesë është unike dhe se çdo brendshme është e dallueshme dhe unike.

*Guri natyror për ambiente të jashtme publike* është zgjidhja më e mirë për bukuri të qëndrueshme. Pavarësisht nëse ndërtohen apo rinovohen zona të reja publike, guri natyror ofron pamje të pëlqyeshme për syrin e njeriut. Ai i shton vlerë reale vendbanimit.

Guri është i natyrshëm, që do të thotë se secila pjesë është unike dhe se secila zonë publike është kështu e njohur dhe unike.

*Guri natyror për fasada strukturale*

Një nga avantazhet më të mëdha të gurit për fasada është qëndrueshmëria. Qëndrueshmëria e tij përcaktohet nga vetitë e tij fizike dhe mekanike, si forca e lartë në shtypje dhe rezistenca ndaj konsumit, ngrirjes, ndikimeve atmosferike, etj.

Nëse guri për fasada është instaluar dhe mirëmbajtur siç duhet, ai mund të zgjasë për dekada ose më shumë.

*Guri natyror për fasadën* është një izolant i shkëlqyer, me instalimin e tij kostot e ftohjes dhe ngrohjes janë reduktuar në minimum. Gjithashtu, së bashku me dritaret dhe dyert e mira, izoluesi i zërit është më i miri.

Një gjë tjetër që është shumë e rëndësishme - guri për fasadë është rezistent ndaj zjarrit.

## 4.1. Projekti teknologjik për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar

Projekti do të punohet tërësisht sipas dispozitave ligjore, rregulloreve dhe standardeve për objekte investive tekniko-teknologjike, i cili në bazë të detyrave projektuese përbëhet nga:

1. Fortina (bunkeri) me kapacitet pranues $25m^3$.
2. Tavolina dozuese
3. Grilla ndarëse
4. Thërmuesi me nofulla
5. Shiriti kryesor transportues
6. Parasita
7. Mulliri me çekiça (primar)
8. Thërmuesi rrotativ (sekondar)
9. Sita primare vibruese tre katëshe (ndarësi I frakcioneve për fasada strukturale)
10. Shiritat transportues për frakcionet e thërmuara
11. Mekanizmi për formësimin e gurëve të mermerizuar (Barabani rrotullues në formë cilindri I vendosur në pozicionin horizontal.



Fig 2. Skema teknologjike e vendosjes së linjës së përpunimit të gurëve të mermerizuar

Në të shumtën e rasteve linjat e përpunimit të gurëve dekorativ pozita e pare nga e cila fillon procesi teknologjik për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar apo në përgjithësi të gurëve të fortë dekorativ është bunkeri pranues i gurit të sjellur nga fusha e shfrytëzimit.
Në linjën të kompanisë "Guri Company" sh.p.k. bunkeri pranues do të ketë një kapacitet afro 25 $m^3$.
Fortina ( bunkeri 25 $m^3$)
Tavolina dozuese me sistem vibrimi, figura n vijim.



*Figura 3. Tavolina dozuese me sistem vibrimi*

Në pjesën e poshtme të fortinës është e vendosur tavolina dozuese e cila bënë ushqimin e thërmuesit primar me traj, kjo tavolinë punon me sistem vibrimi, vibrimet e të cilit elektromotor janë të sinkronizuara me kapacitetin përpunues të thërmuesit primar në mënyrë që të mos vie deri te ndonjë moment që të ketë pengesa të llojit të ndryshëm.

- ***Grilla ndarëse***

Grilla ndarëse do të jetë mekanizëm e cila do të bën ndarjen e materialit shterpë I cili është pjesë e materialit të minuar në fushën e shfrytëzimit. Grilla ndarëse do të jetë e përbërë nga një sistem shufrash të vendosura në tre rende njëra pas tjetrës në formën kaskadë. Këto shufra janë të përbëra nga material rezistent në abrazivitet dhe goditje, zakonisht janë të veshura me një shtresë mangani.

Edhe grilla ndarëse punon me një sistem dhe bëhet ndarja e materialit shterpë I cili përmes një shiriti transportues bartet dhe stivohet në një vend të caktuar.



*Figura 4. Grila ndarëse*

- ***Thërrmuesi me traj***

Thërmuesit primar me traj i prodhimit Zviceran i tipit AMMAN, bënë pranimin e gurëve 1.40 x 1 m, duke përgatitur frakcionet për mullirin sekondar, figura ne vijim.



*Figura 5. Thërrmuesi me traj*

- ***Shiriti kryesor transportues***

Shiriti kryesor transportues do të jetë I vendosur nga thërrmuesi primar e deri te thërmuesi sekondar, ky shirit do të jetë i përbërë nga tri rrula të vendosura pjerrtazi me një kënd 17-21 ᵒ . Shiriti i gomës në këtë pozicion duhet të jetë minimum tre shtresor sepse u nënshtrohet të gjitha presioneve dhe ngarkesave të ndryshme për shkak se bënë transportimin e materialit që del nga mulliri primar.

Forca e e cila e vë në lëvizje shiritin transportues varet nga gjatësia e shiritit dhe këndi i pjerrtësisë dhe kjo fel. nuk guxon të jetë nën 7.5 kW kurse reduktori duhet të ket 60 rrot/ min. Nga ky shirit materiali i thërrmuar kalon në parasitë e cila bënë ndarjen e materialit 0-60 mm , ku përmes një shiriti transportues ky material stivohet në një vendë të caktuar për tu përdorur nga kompania për nevoja të ndryshme kurse materiali mbi sitë kalon në mullirin primar me çekiça për të ju nënshtruar procesit të ma tutjeshëm të thërrmimit.




*Figura 6. Shiriti kryesor transportues*

- ***Mulliri me çekiçë***

Ky mulli është i përbërë nga çekiçë fluturues të cilët nën forcën e inercionit godasin gurët duke ethërmuar.

Thërmimi vjen edhe si pasojë e goditjes së gurëve në murin frontal të pjesës statike të mullirit. Më pastaj, përmes shiritit transportues shkon në sitën primare vibruese katër katëshe për tu ndarë apo seperuar në fraksione sipas llojit të sitave.



*Figura 7. Mulliri me çekiçë*

- ***Sita primare vibruese tre katëshe***

Materiali i cili do të thërmohet në mullirin me çekiça permes shiritit transportues shkon në sitën primare vibruese katër katëshë në të cilën bëhet ndarja e frakcioneve sipas gabariteve., këto frakcioneve permes shiritave gjegjës transportues deponohen nëpër vende të caktuara kurse materiali mbi site gabaritet e të cilit janë mbi 32 mm shkojnë në ribluarje në mullirin rrotativ dhe në mënyrë ciklike materiali I cili është mbi 16 mm prap kthehet në ribluarje në mullirin me çekiça. Sipërfaqja sitëse e sitës do të jetë 12 m2



*Figura 8. Sita primare vibruese tre katëshe*

- ***Mekanizmi për formësimin e gurëve të mermerizuar***

Mekanizmi për formësimin e gurëve të mermerizuar (Barabani rrotullues) apo mikseri në formë cilindri I vendosur në pozicionin horizontal.



Figura 9. *Mekanizmi për formësimin e gurëve të mermerizuar*

Principi i punës së këtijë mikseri është i thjeshtë dhe bazohet në inercion respektivisht në përolasje të gurëve të përgatitur paraprakisht (të thyer dhe të situr ), nga kjo përplasje mes gurëve dhe mureve të mikserit, gurët marrin forma të buta dhe jo të thepisura dhe si të tilla përdoren për dekorimin e ambienteve të ndryshme (gabaritet e formësuara do tu përshtaten kërkesave të klientëve në treg).

## 4.2. Vlera investive e projektit

| **Nr** | **Lloji i investimit** | **Shuma në euro** |
|---|---|---|
| 1 | Punët tokësore (mihja rrafshimi, betoni)<br>i kryen vet kompania. | 10,000.00 |
| 2 | Makinat operacionale fikse | 135,000.00 |
| 3 | Makinat mobile | 45,000.00 |
| | **Total** | **190,000.00** |

## 4.5. Alternativat e projektit

Janë analizuar alternativat tjera për lokacione te mundshme, por marre parasysh lokacionin aktual, ky lokacion është vlerësuar me përparësi.

Hulumtimi dhe disponimi me rezervate mjaftueshme për këtë aktivitet është përcaktues për këtë lokacion.

Përparësitë e këtij lokacioni janë, qasja ne rrugën ku gravitojnë rrugët e Racakut, Komunës se Shtimes dhe përtej saj Rruga për Kaçanik, përkatësisht auto udha Arbër Xhaferi, qe lidhe Kosovën qendrore me Shkupin.

Te gjitha hulumtimet tjera dhe vlerësimet për alternativa tjera te këtij projekti kane rezultuar si sekondare ose terciare, duke e fuqizuar alternativen ekzistuese te këtij projekti.

# 5. VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NE MJEDIS

## 5.1. Ndikimet në ajër

Në aktivitetin për bluarjen, seperimin dhe përpunimin e gurit të mermerizuar, ndikimet negativ në mjedis shprehet edhe në ambientin e ajrit mund të ketë gjatë ngarkimit të kamionëve transportues me material të minuar.

Në zonën e shtrirjes mekanizmit punues ajri është i pastër. Deri te ndotja mundë të vjen për shkak të ndonjë avarie eventuale në sistemin e ujit i cili do të jetë i montuar në pozicionet e derdhjes së fraksioneve gjatë bluarjes. Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës , por duke ju falënderuar formës së relievit dhe konfiguracionit të terrenit bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta, pasi që ato janë larg nga lokacioni ku do të përpunohet guri i mermerizuar. Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimit të gazrave nga automjetet e ngarkimit dhe transportit të cilat si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës. Përbërja e gurit të mermerizuar gjatë përpunimit nuk përmban materie të dëmshme.

## 5.2. Ndikimet në tokë

Si ndikim negativ në tokë paraqitet masa sterile e cila duhet të largohet nga sipërfaqet e punës. Trashësia e sterilit sillet prej 10 cm gjerë 30 cm, depozitimi i tij duhet të bëhet në konsultim me projektuesin në zonën e punishtes, në një anë ku nuk pengon proceset minerare. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasuesin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe me ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.

Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshme nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre.

## 5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuesit e mësipërm të cilat me derdhjen tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.

Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj. Në këtë pjesë përshkak të përbërjes së lokacionit ga material I eroduar në kohë nuk ndonjë rrjedhë ujore e cila do të ndotej.

## 5.4. Ndikimi në peizazh

Lokacioni ku bëhet përpunimi i gurëve dekorativ, gjithnjë do të merr dhe ka marrur pamjen e një vendi industrial sepse kjo vonë është e njohur për zhvillimin e bizneseve në sektorin minerar.
Gjatë fazës së shfrytëzimit normalisht, peizazhi do të pësojnë një degradim i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të shfrytëzimit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit me rrethinën .
Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensim të shfrytëzimit të pasurive, resurseve natyrore.

## 5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në impiantin e përpunimit të gurëve dekorativ dhe atë në sipërfaqet operacion ale ne gjatësinë kohore të aktivitetit, flora tërësisht do të shkatërrohet e cila duhet të ri kultivohet pas përfundimit të punëve minerare.
Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

## 5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Në kompleksin e punimeve për përpunimin e gurëve dekorativ, nuk ka objekte banimi , nuk do të kemi ndonjë rast të zhvendosjes së popullatës dhe as që pritet në të ardhmen të ketë për shkak të punimeve minerare.
Zhvillimi i veprimtarisë përpunuese në këtë lokalitet ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rajoni. Kompania ”Guri Company” sh.p.k. për të zhvilluar veprimtarinë e vetë do të jetë i obliguar të punësojë një numër të punëtorëve, kryesisht nga popullata vendase, nga kjo del se ne aspektin social eksploatimi I gurit të mermerizuar do të ketë ndikime pozitive. Guri i këtij vendburimi që do të përpunohet nuk përmban materje të rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

## 5.7. Zhurma

Zhurma, si element në teknologjinë e përpunimit të gurit dekorativ ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara, duke pasur parasysh largësinë e tyre nga lokacioni.

Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve minerare kryesisht nga makinat gjatë procesit të bluarjes, transportit etj.

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese bashkohore në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim duhet të jetë 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës nuk do të punohet, por edhe kur punohet nuk do të jetë më e madhe se 45 dB.

Ne vijim po e paraqesim ne formë tabelore nivelin e zhurmës në varsh mëri nga distanca.

Tabela-2 niveli I zhurmës në varsh mëri nga distanca.

| Zhurma | Distanca(m) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 10 | 50 | 100 | 500 |
| 90 dB-niveli<br>Për paisje moderne | 59 | 45 | 39 | 25 |

## 5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që në aktivitetin e përpunimit të gurit mekanizmi punues do të jenë mirë të mirëmbajtura , dhe të monitoruara nga ekspertët e lemive përkatëse dhe njëherë kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, por thjesht me materialin që e marrim po nga ky mjedis.

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

- Gjatë bluarjes dhe seperimit dhe përpunimit të gurit të mermerizuar
- Gjatë proceseve tjera teknologjike në përpunimin e lëndës së parë
- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes).

# 6. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

## 6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative të mundshme në ajër që do të krijohen nga realizimi i proceseve teknologjike për përpunimin e gurit të mermerizuar të cilat i kemi cekë më lartë duhet ndërmarr këto masa:

- Nuk duhet të punohet në kohëra me erëra.
- Të gjitha sipërfaqet operacionale dhe rrugët ( pjesët e pa asfaltuara) ku dotë bëhet transportimi i masës shkëmbore duhet vazhdimisht të spërkatën me ujë.
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i mekanizmit punues
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me
- mbulesa adekuate.
- Duhet rregullisht të jetë ne disponim cisterna me ujë rezervë.

## 6.2. Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë nga realizimii proceseve teknologjike për përpunimin e gurit të mermerizuar duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuar për
- shfrytëzim të mëtutjeshëm si dhe mos të lejohet kalbja e tyre.
- Pjesën humusore dhe argjilore të materialit steril duhet deponuar në vende të posaçme me qëllim të ruajtjes për rekultivim biologjik.
- Erozionin duhet ta pengojmë me anë të rikultivimit biologjik ku është e
- mundur.
- Varësisht nga fronti i punëve në punishte, në kohën më të shkurtër që është e mundur duhet të filloj procesi i rikultivimit, me ç' rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushje dhe nivelim të hapësirave të krijuara nga proceset e përpunimit të gurit të mermerizuar.
- Duhet të merren masat e nevojshme për mos le shuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë, në ofiçinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe

transportuese.

- Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i pjesëve në lokacionin e përpunimit të gurit të mermerizuar për shkak te avarive ne makinat përpunuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe lubrifikantëve dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në punishte nga depozitimi I pluhurit duhet që kohë pas kohe të pastrohen për të ruajtur nivelin e kënaqshëm në punishte.
- Mbeturinat e lëngëta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

## 6.3. Masat për mbrojtjen e ujit

Mbrojtja e sipërfaqes operacionale nga ndotësit e ngurtë të cilët mund të ndodhin gjatë bartjes me ujë nga të reshurat atmosferike duhet të bëhet me krijimin e kanalit rreth e përqark sipërfaqes impiantit.

Ky kanal nevojitet për mbrojtjen e fushës operacionale nga vërshimet e të reshurave atmosferike, dhe mbrojtjen e ujërave nga ndotësit mekanik dhe ndotësit me vajra e derivate, prandaj për pastrimin e ujërave të cilët rrjedhin nga hapësirat e përpunimit gjatë të reshurave atmosferike, duhet të rregullohen puset sedimentuese për sedimentimin e materieve të ngurta dhe seperatori për pastrimin e ujit të ndotur me vajra e derivate të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionaletë mihjes sipërfaqësore, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e pastra të lëshohen në recipient.

Ujërat e zeza duhet së pari te trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohen varshmëri me numrin e punëtorëve e pastaj të lirohen ne recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga pronari apo kompanitë e licencuara.

## 6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Pas vendosjes së mekanizmit përpunues dhe fillimit të përpunimit të gurit të mermerizuar, duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmëme ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në raste se zhurma e mesit nga matjet do të tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha

masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuarës sipas rregullave në fuqi.

Në varsh mëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vendetë punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

## 6.5. Masat për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore

Masat për mbrojtjen e botës bimorë kryesisht lidhen ngushtë me ruajtjen e tokave në pjesët e ngastrave shfrytëzuese nga erozioni dhe masave mbi mbrojtjen e ajrit. Kompania duhet të ketë kujdes që të mos deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merën masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës së përpunimit, dhe të kenë kujdes në nivelin ezhurmës, kualitetin e ajrit etj.

## 6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale

Për të evituar rreziqet aksidentale që mundë të ndodhin gjatë përpunimit të gurit të mermerizuar duhet ndërmarrur këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- Duhet të kenë ne disponim kemikate neutralizuese për karburante të naftësdhe vajra.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet e tërë zona e punishtes të thuret me tel gjembor.
- Të merën të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë,
- mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

## 6.7. Aktivitetet në raport me publikun

